



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Prill 2021

Nr: 200

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE PËR SHKELJE TË  
PARASHIKUAR NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020 TË KOMISIONIT  
RREGULLATOR NDAJ Z. ERION VELIAJ**

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj,

Kërkues: Lëvizja Socialiste për Integrim

Ndaj: Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë

Baza ligjore: Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, dokumentacionin e administruar gjatë procesit të hetimit administrativ:

**VËREJ:**

I.

Vlerësimi paraprak



Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë raportuar disa denoncime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluara”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), për veprimtaritë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, i cili ka publikuar në llogarinë e tij personale në Facebook, disa foto dhe video me qytetarë të ndryshëm duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

Kallëzimet e paraqitura nga kallëzuesi ruhen në sistem elektronik dhe identifikohen me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Kallëzimet e bëra në ndërfaqe/ portal deri me datën 30.1.2021 për këtë subjekt janë si vijon:

1. Denoncimi i raportuar më datë 2.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1224 ora 08:58, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se: “Më datë 18.01.2021 Kryetari i Bashkisë z. Erion Veliaj ka postuar në faqen e tij Facebook një veprimtari ku dorëzon banesat e rindërtuara nga tërmeti disa familjeve në Farkë”. Lidhja për aktivitetin: [https://fb.ëatch/3b\\_FGë5CMy/](https://fb.ëatch/3b_FGë5CMy/)
2. Denoncimi i raportuar më datë 2.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1227, ora 09:01, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se: “Më datë 21.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj ka postuar zhvillimin e një aktiviteti me karakter publik duke dorëzuar banesën e rindërtuar nga tërmeti disa qytetarëve në Bërzhitë”. Lidhja për aktivitetin: <https://fb.ëatch/3bY9sIKRY5/>
3. Denoncimi i raportuar më datë 2.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1231 ora 09:03, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se: “Më datë 14.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj ka postuar një aktivitet ku duket se ai i dorëzon çelësat e shtëpive të rindërtuara nga tërmeti, disa familjeve në Dritas”.
4. Denoncimi i raportuar më datë 2.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1235 ora 09:05, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se: “Më datë 19.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj me anë të një postimi në faqen e tij Facebook postoi një veprimtari ku së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë, z. Edi Rama dhe Ministrin e Rindërtimit z. Arben Ahmetaj i dorëzojnë banesat e rindërtuara nga tërmeti dy qytetarëve në Zall-Herr”.
5. Denoncimi i raportuar më datë 2.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1240 ora 09:06, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se: “Më datë 30.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj ka publikuar në faqen e tij Facebook një aktivitet ku ka dorëzuar banesën një qytetari në Kryevidh të Rrogozhinës”. Lidhja për aktivitetin: <https://fb.ëatch/3oLQLB8jy/>

6. Denoncimi i raportuar më datë 2.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1244 ora 9:07, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se: “Më datë 27.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj ka publikuar një veprimtari ku së bashku me Ministrin e Rindërtimit Arben Ahmetaj dhe Kryeministrin e Shqipërisë z. Edi Rama kanë inaguruar banesën e rindërtuar nga tërmeti, të një familjeje në Vaqarr”. Lidhja për aktivitetin: <https://fb.ëatch/3oKp8ZErV3/>
7. Denoncimi i raportuar më datë 2.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1248 ora 9:08, në ndërfaqjen e KQZ-së pretendohet se: “Më datë 12.01.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj ka publikuar në faqen e tij Facebook një aktivitet ku duket se ka inaguruar banesat e rindërtuara nga tërmeti dy familjeje në Mumajes”.

Sipas denoncuesit “*Këto veprimtari të tij bien ndesh me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, shkronja "d", të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilët parashikojnë si veprimtari të ndaluar mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike

Referuar kompetencave sa më sipër Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi shqyrtimin bashkërisht të denoncimeve pasi konstatoi se kishin të njëjtin subjekt dhe objekt, në të cilat pretendohesh shkelje të parashikuara në nenin 3, paragrafi 1.1, shkronja “d”, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

## II.

### Rrethanat e fakti

Nga datat 12.1.2021 deri me datë 30.1.2021, subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim ka kallëzuar në ndërfaqjen e KQZ-së dedikuar aktiviteteve të ndaluara, aktivitete të zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, të pasqyruara dhe në faqen e tij të facebook, të referuara si në vijim:

1. Sipas denoncimit të raportuar më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1224 ora 8:58, në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesat e disa familjeve në farkë.
  - a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezulton i raportuar në datë 17.01.2021 ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
2. Sipas denoncimit të raportuar më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1227, ora 09:01, në ndërfaqjen e KQZ-së, denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesat e disa qytetarëve në Bërzhitë.
  - b) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezulton i raportuar në datë 18.01.2021 ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
3. Sipas denoncimit të raportuar më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1231 ora 9:03, në ndërfaqjen e KQZ-së, denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesat e disa familjeve në Dritas.
  - c) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezulton i raportuar por me të dhëna të paplota në ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
4. Sipas denoncimit të raportuar më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1235 ora 9:05, në ndërfaqjen e KQZ-së, denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesat e disa familjeve në Zall-Herr.
  - a) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezulton i raportuar në datë 18.01.2021 ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
5. Sipas denoncimit të raportuar më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1240 ora 9:06, në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesën një qytetari në Kryevidh të Rrogozhinës.
  - b) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezulton i raportuar në datë 30.01.2021 ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e

veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.

6. Sipas denoncimit më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1244 ora 9:07, në ndërfaqjen e KQZ-së, zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj së bashku me Ministrin e Rindërtimit Arben Ahmetaj dhe Kryeministrin e Shqipërisë z. Edi Rama , në banesën e një familjeje në Vaqarr.
  - c) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezulton i raportuar në datë 25.01.2021 ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
7. Sipas denoncimit të më datë 2.2.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1248 ora 9:08, në ndërfaqjen e KQZ-së denoncohet zhvillimi i një aktiviteti nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në banesat e dy familjeve në Mumajes.
  - d) Sipas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ zhvilluar nga KQZ, ky aktivitet rezulton i raportuar në datë 08.01.2021 ndërfaqjen e KQZ-së, krijuar për raportimin e veprimtarive publike sipas vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, nga institucionet publike, subjekt i këtij vendimi.
1. Referuar denoncimeve të mësipërme Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1467 prot., datë 24.2.2021 dhe me shkresën 2572 prot., datë 24.3.2021, ka kërkuar informacion personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive me karakter publik në Bashkinë Tiranë, z. Alban Dokushi në lidhje me këto aktivitete.
  - Me shkresën nr. 9700/1 prot., datë 5.3.2021, protokolluar me tonën me numër 1467/1, datë 9.3.2021, dhe, z. Alban Dokushi ka sqaruar se:

“Bashkia Tiranë ka vijuar me raportimin e aktiviteteve me karakter publik, përkatësisht në datat, 17.01.2021, 18.01.2021, 08.01.2021, 30.01.2021, 27.01.2021, në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konkretisht përpara datës së planifikuar për zhvillimin e tyre, duke specifikuar elementët në lidhje me datën e zhvillimit, orën, vendin, folësit kryesorë dhe pjesëmarrësit.

Për sa më sipër, Bashkia Tiranë ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator”.
  - Me shkresën nr. 9100/3 prot., datë 26.3.2021, protokolluar me tonën me nr. 2572/1, më datë 29.3.2021, ka sqaruar se për aktivitetin e zhvilluar më datë 14.01.2021, nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në shtëpitë e rindërtuara nga tërmeti, disa familjeve në Dritas, ky aktivitet

është raportuar më datë 7.1.2021 në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

### III.

#### Analiza ligjore

Neni 92 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, përcakton detyrimin e institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve.

Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, përcakton rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik si dhe përkufizon si: *“Veprimtari publike”, të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vijoi procedurën e administrative për shqyrtimin këtyre denoncimeve referuar nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në rast se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar sipas nenit 3, të këtij vendimi, dhe/ose keqpërdorim të burimeve shtetërore, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike përkatëse. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë.

Nga verifikimi i fakteve dhe rrethanave rezultojnë se, këto aktivitete me karakter publik janë raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas datave referuar informacionit të dhënë nga Bashkia Tiranë, përpara datës së planifikuar të zhvillimit të tyre dhe në respektim të kufizimeve të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 9/2020 Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar denoncimit të mësipërm, këto veprimtari të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të provojnë se janë veprimtari të ndaluara në kuptim të përkufizimeve të veprimtarive të ndaluara të përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

#### PËR KËTO ARSYE:



Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n” paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

## V E N D O S :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të nenit 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ. Ky vendin përbën titull ekzekutiv.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3(tre) ditëve nga njoftimi i tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

